Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

RAPORT VJETOR I PUNËS SË AUTORITETIT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE 2011

Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

PËRMBAJTJA

Një vit sukses i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve 6
Korniza Kombëtare e Kualifikimeve – një mundësi më shumë për ty 8
Kush jemi ne 11
Synimet dhe objektivat tona 13
Akterët relevant 15
Konteksti jonë 16
Si i planifikojmë ne 18
Raport Vjetor për vitin 2011 20
Aktivitetet e realizuara 21
1. Korniza Kombëtare e Kualifikimeve 22
2. Kualifikimet në KKK 27
3. Standardet profesionale 33
4. Rregullimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve 35
4. Promovimi i KKK dhe AKK 45
5. Bashkëpunimi ndërkombëtar 74

LISTA E SHKURTESAVE

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim për Arsimin e Lartë
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnime
IPA	Instrumenti i Ndihmës për Para-Anëtarësim (i UE-së)
KAAP	Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korniza Evropiane për Kualifikime
KKK	Kombëtare e Kualifikimeve
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës & Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
SC	Sigurimi i Cilësisë
UE	Unioni Evropian
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian



Ragip Gjoshi
Kryetar i KD të AKK

NJË VIT SUKSES I AUTORITETIT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE

Puna njëvjeçare e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve si organ publik i pavarur, në pajtim me Ligjin për Kualifikime Kombëtare në Kosovë, mund të përkufizohet me angazhimin e një stafi modest, të përgatitur profesionalisht dhe të përkushtuar të AKK- së dhe aktivitetin e Këshillit Drejtues që përfaqësojnë ministritë, organizatat e partnerëve shoqëror dhe universitetet, që kanë zhvilluar një vistër aktivitetesh që kanë avancuar punën e AAK-së.Kështu, u dëshmua se faktor thelbësor i sistemit kombëtar të kualifikimeve në Kosovë ishte Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. AKK këtë vit ishte përqendruar në realizimin e objektivave nga përgjegjësia e tij rreth mbikëqyrjes së kualifikimeve kombëtare, kurse në veçanti do të ketë përgjegjësi për kualifikimet profesionale.

Këtë vit AKK ka bërë mbikëqyrjen e performancës së Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Korniza është vlerësuar si një mjet që do të përdorët nga planifikuesit e zhvillimit të burimeve njerëzore, fuqisë punëtore dhe individëve, të cilët dëshirojnë të përmirësojnë njohuritë e tyre, aftësitë dhe kompetencat për kënaqësi personale apo përmirësim të mundësive të punësimit. Me qëllim të rritjes së cilësisë në arsim dhe që kualifikimet profesionale të orientohen nga nevojat e tregut të punës, është aprovuar sistemi i kualifikimeve në kuadër të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Ky sistem do të sigurojë që kualifikimi për secilin profesion të përcaktohet qartazi në përputhje me njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e gjëra, të cilat janë të nevojshme për një kualifikim profesional që është në pajtueshmëri edhe me kualifikimet evropiane. Ministri i Arsimit, Ramë Buja, ka treguar përkushtim të madh për përmirësimin e sistemit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) në Kosovë, për të siguruar se të rinjtë dhe të rriturit janë në gjendje për të fituar kualifikime, që do të njihet si ekuivalente me ato të lëshuara në vendet e zhvilluara evropiane. Do të përmendja edhe punën e madhe që ka bërë Christof Stock, udhëheqës i Operacioneve të Zyrës Ndërlidhëse të KE, që ka mbështetur reformat e sistemit të AAP në Kosovë përmes gjashtë fazave të projekteve të KOSVET, që janë një arritje që përfaqëson një modernizim të rëndësishëm të arsimit dhe aftësimit në Kosovë, nga të cilat do të përfitojnë qytetarët dhe bizneset. Të gjithë pajtohemi se në klimën e tashme ekonomike është shumë e rëndësishme që Kosova të ketë një fuqi punëtore më të kualifikuar që do të ndihmojë për të tërhequr mbështetjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik. Edhe puna e Teuta Danuzës, drejtoreshë e AKK, si përgjegjëse kryesore për implementimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve me ndihmën e MAShT dhe Bashkimit Evropian përmes fondeve të ndryshme, mundësoi implementimin e Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare. AKK ka nga fillimi i vitit të ardhshëm do të fillojë akreditimin e institucioneve të AAP-së. Janë bërë përgatitjet që të gjithë ofruesit do të kenë të drejtën e aplikimit për aprovim të kualifikimeve dhe akreditim të institucioneve të tyre. Aplikuesit të cilët i plotësojnë kriteret, do të kenë të drejtën të veprojnë si institucione ofruese, vlerësuese dhe lëshuese të kualifikimeve përkatëse. Institucionet e akredituara do të certifikohen nga AKK për një periudhë të caktuar, varësisht nga rekomandimet e panelit të ekspertëve dhe vendimit të Këshillit Drejtues të AKK. Këto kualifikime do të ndihmojnë në punësim dhe do të rrisin njohjen e shkathtësive dhe kompetencave të tyre në tregjet vendore dhe ndërkombëtare të punës.

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE – NJË MUNDËSI MË SHUMË PËR TY



Teuta Danuza
U.D drejtor i Autoritetit
Kombëtar të Kualifikimeve

Ne mund të klasifikojmë vitin 2011 si një vit i të arriturave të shumta. Objektivat kryesore të vendosura nga AKK për 2011 janë realizuar. Objektiva të qarta, punë e vështirë dhe angazhim serioz nga ekipi ynë i vogël i të punësuarve kanë bërë të mundur qe ne t'i shërbejmë një numri të madh të akterëve relevant të KKK dhe publikut të gjerë.

Arritjet më ambicioze në vitin 2011 kanë qenë aprovimi i KKK, si dhe zhvillimi dhe testimi i sistemit të aprovimit të kualifikimeve profesionale në kuadër të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe akreditimit të institucioneve, të cilat do të vlerësojnë dhe lëshojnë këto kualifikime. KKK është një sistem kombëtar për të vendosur kualifikime, të cilat përmbushin standarde të caktuara cilësie

në një nga nivelet hierarkike. Ajo përbëhet nga një strukturë me 8 nivele, që korrespondojnë me nivelet e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, e që synon të përfshijë ta gjithë kualifikimet e zhvilluara dhe lëshuara në Kosovë. Tetë nivelet mbulojnë të gjithë gamën e kualifikimeve nga aftësi bazë që arrihen në fund të arsimit të detyruar, deri tek ato të marra në nivelet më të larta akademike dhe profesionale të arsimit dhe aftësimit. Si një instrument që promovon të mësuarit gjatë gjithë jetës, përfshinë të mësuarit e arritur në mënyrë formale, joformale dhe informale.

AKK gjatë vitit 2011 ka hartuar dhe testuar procedurat dhe kriteret për aprovimin e kualifikimeve profesionale në KKK dhe akreditimin e ofruesve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Kosovë dhe pas testimit ka konstatuar se kualifikimet, të cilat do të aprovohen për t'u përfshirë në KKK, do të jenë në përputhje me nevojat e tregut të punës, duke ngritur kështu cilësinë e Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Kosovë në përputhje me standardet evropiane. Pra, të rinjtë tanë do të fitojnë kualifikime që do të njihet si ekuivalente me ato të dhëna në vendet e zhvilluara evropiane, aftësitë dhe kompetencat e tyre do të bëhen gjithnjë e më e njohura në tregjet vendore dhe ndërkombëtare të punës.
AKK është vetëm dy vjeç dhe për këtë periudhë ka vendosur veten si një pikë referimi për kualifikimet dhe sigurimin e cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional në Kosovë. Në vitin 2012, AKK do të fillojë me procesin e aprovimit të kualifikimeve në KKK dhe akreditimin e institucioneve, që do të vlerësojnë dhe certifikojnë këto kualifikime për të krijuar një kulturë të cilësisë dhe standardeve në fushën e kualifikimeve nga e cila do të përfitojnë shumë akterët të arsimit dhe aftësimit, duke përfshirë edhe ofruesit e AAP, punëdhënësit, nxënësit dhe shoqëria në tërësi.

Për këto të arritura, i jemi shumë mirënjohës Bashkimit Evropian për mbështetjen e ofruar përmes projektit BE KOSVET V dhe shpresojmë në ndihmën e vazhdueshme të BE-së, për të krijuar një sistem të kualifikimeve që përputhet më të mirë të Evropës. Poashtu, i jemi mirënjohës partnerëve dhe donatorëve tjerë që kanë përkrahur punën dhe aktivitet e AKK-së.

Një falënderim i veçantë vlen edhe për Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja, për mbështetjen e iniciativave tona dhe zotimin për përkrahje të mëtejme të AKK-së dhe KKK-së. Gjithashtu, do të falënderoja Këshillin Drejtues dhe Stafin ekzekutiv të AKK-së për kontributin madhor në zhvillimin e institucionit si dhe performancën gjatë vitit 2010-11.

AKK është vetëm dy vjeç dhe për këtë periudhë ka vendosur veten si një pikë referimi për kualifikimet dhe sigurimin e cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional në Kosovë.

AUTORITETI KOBMBËTAR I KUALIFIKIMEVE

KËSHILLI DREJTUES

Ragip Gjoshi	Kryetar i Këshillit Drejtues të AKK-së (MAShT)
Anton Gojani	Nënkryetar i Këshillit Drejtues të AKK-së (Don Bosko)
Agim Shahini	Anëtar -Aleanca Kosovare e Biznesit
Arbëresha Turjaka	Anëtare- Ministria e Shëndetësisë
Avdi Smajlaj	Anëtar -Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Bedri Xhafa	Anëtar - Agjencioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë
Besim Mustafa	Anëtar- Oda Ekonomike
Edita Krasniqi	Anëtare -Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ferdije Zhushi	Anëtare - Agjencia e Akreditimit të Kosovës
Ilir Ibrahimi	Anëtar- Universiteti Amerikan i Kosovës
Mehreme Llumnica	Anëtare -Handikos
Menderes Ibra	Anëtar -Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Tahir Arbneshi	Anëtar -Universiteti i Prishtinës

STAFI EKZEKUTIV

Teuta Danuza	U.D. drejtore
Avni Gashi	Ekspert për sigurim të cilësisë
Bleta Kadriu	Eksperte për standarde
Milot Hasangjekaj	Ekspert për kualifikime
Kaltrina Mulliqi	Eksperte për sigurim të cilësisë
Donjeta Nimani	Asistente Administrative



KUSH JEMI NE

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) është organ i pavarur publik i themeluar në Dhjetor të vitit 2009 bazuar në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Ligji 03/L-060).

AKK ka përgjegjësi të përgjithshme për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK); në përcaktimin e niveleve të kualifikimeve në KKK, harmonizimin e niveleve të kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), caktimin e kritereve për aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional (AAP), përfshirjen e kualifikimeve të aprovuara në KKK, lehtësimin e progresit dhe transferit ndërmjet formave të ndryshme të mësuarit, dhe sigurimin e cilësisë në institucionet e akredituara të AAP.

AKK ka Këshillin Drejtues prej trembëdhjetë (13) anëtarësh, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe përfaqësuar nga ministritë, organizatat e partnerëve socialë dhe universitetet publike.

AKK ka stafin ekzekutiv prej gjashtë (6) anëtarëve: u.d drejtores, zyrtares për standarde, zyrtarit për kualifikimeve, dy zyrtarëve të sigurimit të cilësisë dhe asistentes administrative.





Pamje nga trajnimi për kualifikimin e elektroinstaluesit.



SYNIMET DHE OBJEKTIVAT TONA

Misioni i AKK-së është të mbikëqyrë dhe zhvillon Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës në partneritet me nxënësin/kandidatin, punëdhënësin dhe ofruesit e Arsimit dhe Aftësimit në të gjitha nivelet dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë.

Vizioni i AKK-së është krijimi i një sistemi cilësor të besueshëm dhe transparent të kualifikimeve kombëtare me qëllim të rritjes së mundësive për mobilitet kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për të arritë këtë AKK do të:

- aprovojë kualifikimet që do të përfshihen në nivelet e caktuara të kornizës dhe riaprovojë ato sipas nevojës;
- akreditojë, rregullojë dhe monitorojë ofruesit e Arsimit dhe Aftësimit Profesional;
- zbatojë sigurimin e jashtëm të cilësisë së vlerësimeve, që qojnë te dhënia e kualifikimeve në KKK;
- mirëmbajë bazën e të dhënave dhe evidencat e verifikuara dokumentuese të kualifikimeve në KKK dhe të certifikatave dhe diplomave të dhëna;
- bëjë rishikime periodike të vlerësimit dhe krahasime ndërkombëtare të kualifikimeve;
- këshillojë institucionet përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike ose punësim, mbi çështjet e krahasueshmërisë dhe barasvlerës;
- Certifikatat dhe diplomat e dhëna për të gjitha kualifikimet në kornizë miratohen me vulë të autoritetit dhe përfshijnë titullin e aprovuar të kualifikimit, nivelin e tij në KKK dhe informata të tilla varësisht nga kërkesa e AKK.



Një nga takimet e AKK-së me akterët relevant të KKK-së në Peje.



AKTERËT RELEVANT

Për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë, AKK krijon dhe mirëmban raporte bashkëpunuese dhe procese konsultative me të gjithë akterët relevant të KKK, përfshirë:

- Nxënësin/kandidatin
- Mësimdhënësit dhe trajnerët
- Menaxherët në shkolla, kolegje universitare dhe universitete
- Koordinatorët për sigurimin e cilësisë tek ofruesit
- Punëdhënësit dhe punëtorët
- Ofruesit publik dhe privat të aftësimit profesional
- Sindikata dhe shoqata profesionale
- Qeverinë në nivel qendror dhe lokal
- Agjenci dhe Këshille në nivel kombëtar


KONTEKSTI JONË

Sistemi i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) dhe Arsimit të lartë në Kosovë, duhet të i plotësojë në mënyrë adekuate nevojat e ekonomisë së tregut. Ngritja e cilësisë së sistemit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit të lartë është prioritet i Qeverisë së Kosovës në mënyrë që shkathtësitë profesionale dhe kompetencat e individëve që përfundojnë AAP dhe AL të jenë në nivel të kënaqshëm. Për momentin, ende mbetet sfidë për Kosovën të krijojë një fuqi punëtore të aftë, fleksibile që të mund të konkurrojë në tregun vendor, rajonal dhe global.

Prandaj, një ndër kriteret kryesore që duhet të plotësojnë kualifikimet për t'u aprovuar dhe vendosur në KKK është përputhja e këtyre kualifikimeve me kërkesat e tregut të punës. Në këtë mënyrë ky është ndikimi i drejtpërdrejtë i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në ekonominë kosovare. Kjo kornizë me kriteret e saj parasheh që fillimisht institucionet, të cilat dëshirojnë të zhvillojnë një kualifikim duhet të paraqesin dëshmi se kualifikimi është i kërkuar në tregun e punës. Dëshmi mund të jenë hulumtimet e tregut të punës, konsultimet, rekomandimet e institucioneve qeveritare, që zhvillojnë politika zhvillimore si MAShT, KAAP, OEK, MPMS, etj. Gjithashtu, sipas KKK kualifikimet e zhvilluara duhet të bazohen në standarde profesionale, që është baza e kualifikimit. Këto standarde profesionale duhet të zhvillohen drejtpërdrejt bazuar në kërkesat e profesionit të caktuar në vendin e punës. Pra, punëdhënësi merr



pjesë aktive në këtë proces dhe paraqet kërkesat e nevojshme, të cilat punëtori duhet të i demonstrojë për kualifikim në fjalë. Kjo është një ndër kriteret e KKK që duhet të plotësohen nga institucionet të cilat zhvillojnë kualifikime.



AKK ka zhvilluar dhe hartuar udhëzues të shumtë, që do të ndihmojnë institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional të përmbushin këto kritere dhe të jenë pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.



SI I PLANIFIKOJMË NE

AKK zhvillon politikat dhe strategjitë për krijimin dhe zbatimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve në pajtueshmëri me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Nr.03/L-060).

Bazuar në objektivat strategjik të AKK-së, ne zhvillojmë Planin e Punës së AKK-së duke përcaktuar prioritetet dhe aktivitetet për 12 muajt e ardhshëm. Stafi ekzekutiv i AKK-së është përgjegjës për zbatimin e zotimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Punës, ndërsa në çdo takim të KD të AKK-së rishikohet progresi i aktiviteteve sipas Planit të Punës.

AKK paraqet raportin mbi progresin e aktiviteteve të veta tek MAShT, Zyra e Kryeministrit dhe ministritë relevante të AKK, çdo gjashtë muaj, ndërsa raportin vjetor e parashtron te Qeveria e Kosovës.



Një nga takimet e Këshillit Drejtues të AKK-së.



RAPORT VJETOR PËR VITIN 2011

Ky raport është një përmbledhje e të gjitha aktiviteteve dhe objektivave të realizuara të Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve gjatë vitit 2011, në përputhje me Planin e veprimit të saj për vitin 2011, në përputhje dhe në harmoni me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, si dhe në përputhje me Raportin Fillestar dhe Termat e Referencës të Projektit BE KOSVET V. Në këtë raport do të paraqiten të ndarë në sektorë të gjitha aktivitetet e realizuara për zhvillimin dhe implementimin e KKK gjatë këtij viti.

AKTIVITETET E REALIZUARA

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) është përgatitur nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), me mbështetjen e projektit BE KOSVET V, financuar nga Bashkimi Evropian. Është hartuar përmes një procesi të gjatë konsultativ me të gjithë akterët relevant, fillimisht është aprovuar një draft version (Shkurt 2011), ndërsa KKK tani përfshinë ndryshimet që pasqyrojnë mësimet e nxjerra nga testimi në terren. Korniza është aprovuar ne Dhjetor të 2011 nga Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve është një komponent e rëndësishme në kuadër të reformave të sistemit të arsimit, e veçanërisht Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Kosovë. Me këtë synohet të përmirësohet qasja në punë dhe të mësuar e mëtutjeshëm, duke u siguruar që kualifikimet të jenë në harmoni me kërkesat për punësim, t'i përmbushin kërkesat e nxënësve, të ekonomisë dhe institucioneve të arsimit dhe aftësimit. KKK do të mbështesë përmirësimet cilësore në zhvillimet e kualifikimeve të arsimit dhe aftësimit, të cilat janë të bazuara në standarde të krahasueshme ndërkombëtare të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të mbështetura nga sigurimi rigoroz i cilësisë. Duke ofruar një transparencë të sistemit të kualifikimeve kombëtare, duke qartësuar natyrën e kualifikimeve, ndërlidhjen e kualifikimeve dhe duke ofruar një bazë për arritshmëritë përgjatë të gjitha pjesëve të sistemit të arsimit dhe aftësimit, KKK do të mbështesë progresin dhe lëvizshmërinë për mësim gjatë gjithë jetës, përmes shtigjeve të arsimit dhe aftësimit. Të mësuarit fleksibil, të fokusuar sipas kërkesave të individëve për punësim do të ofrojë rritjen e mundësive për njohjen e mësimit paraprak, qasjes në vlerësim dhe certifikim. Është me rëndësi që KKK do të ofrojë bazë për bashkëpunim dhe njohje reciproke ndërmjet KKK dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK).



Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) është përgatitur nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), me mbështetjen e projektit BE KOSVET V, financuar nga Bashkimi Evropian.

Me këtë synohet të përmirësohet qasja në punë dhe të mësuar e mëtutjeshëm, duke u siguruar që kualifikimet të jenë në harmoni me kërkesat për punësim, t'i përmbushin kërkesat e nxënësve, të ekonomisë dhe institucioneve të arsimit dhe aftësimit.

Korniza e Kualifikimeve Kombëtare				
Niveli i KKK-së	**Përmban kualifikime të shoqëruara me**			Niveli referues i KEK
8	Arsimi i lartë – cikli i 3të i Bolonjës (Doktorata)	Doktorata (A)	Hyrja në, ose vazhdimi i zhvillimit profesional brenda niveleve të ulëta të menaxhimit apo drejtimet profesionale të nivelit të lartë	**8**
7	Arsimi i lartë – cikli i 2të i Bolonjës (Masteri)	Grada Master (A)		**7**
6	Arsimi i lartë – Cikli i parë i Bolonjës (Bachelor)	Grada Bachelor (A)		**6**
5	Cikli i shkurtër i Bolonjës dhe/ose AAP post sekondar	Titulli i kualifikimit ende i pa njohur (A), (C) Certifikatat e ofruesve jo formal (D apo E)	Specialisti/Trajneri /Menaxheri	**5**
4	Përgatitja për progres në arsim të lartë dhe/ose hyrja në treg të punës	Diploma e Maturës për lëndët e përgjithshme apo profesionale (B), (C), Diploma e arsimit profesional (C)	Punëtori/mbikëqyrësi i kualifikuar	**4**
3	Përgatitja për tregun e punës (të rinjtë dhe të rriturit)	Certifikata arsimore profesionale (C) Certifikatat e ofruesve jo formal të APP-së (D apo E)	Punëtori/mbikëqyrësi i kualifikuar	**3**
2	Progresi nga arsimi i mesëm i ulët tek ai i lartë (të rinjtë), përgatitja për tregun e punës (të rriturit)	Nuk janë definuar kualifikime ekzistuese të sistemit arsimor formal Certifikatat e ofruesve jo formal (D apo E)	Punëtori/mbikëqyrësi i kualifikuar	**2**
1	Arsimi fillor	Nuk janë definuar kualifikime ekzistuese të sistemit arsimor formal Certifikatat e ofruesve jo formal (E)	Niveli minimal i shkathtësive themelore, përfshirë shkollimin/numrin e nevojshëm për hyrje në nivelin me të ultë të punësimit	**1**

Struktura themelore e Kornizës përbëhet prej tetë niveleve, në të cilat kualifikimet, modulet dhe çdo komponentë tjetër e kualifikimeve mund të vendosen. Secili nivel i KKK është i përcaktuar me nga një formulim të rezultateve tipike të mësimit. Këto rezultate janë të tri llojeve: njohuri, shkathtësi dhe kompetenca më të gjëra.

Korniza synon të përfshijë të gjitha llojet dhe nivelet e kualifikimeve dhe certifikimeve dhe secili nivel i Kornizës do të përmbajë kualifikimet e madhësive të ndryshme, si dhe këto kualifikime do të hartohen për qëllime të ndryshme.
Një kualifikim në KKK është i definuar sipas Ligjit për Kualifikimet si: "njohje zyrtare e të arriturave, me të cilin njihet përfundimi i arsimit ose aftësimit, ose realizimi i kënaqshëm në një test apo provim". Për t'u përfshirë në KKK, të gjitha kualifikimet duhet të bazohen në rezultatet mësimore dhe duhet të jenë subjekt i vlerësimit me sigurim të cilësisë. Ato gjithashtu duhet t'i plotësojnë kriteret për validim dhe validohen nga organi i autorizuar. Secili kualifikim do të vendoset në një nivel të KKK. Një kualifikimi/ moduli do t'i caktohet një vlerë e kredisë. Kualifikimet e KKK do të ofrohen vetëm nga institucionet e akredituara.
Mësimi që shpie në këto kualifikime mund të zhvillohet në kontekste dhe lloje të ndryshme të institucioneve. Kjo përfshinë: shkollat e mesme e të ulëta, gjimnazet dhe shkollat profesionale, qendrat për aftësim profesional dhe ndërmarrjet, ofruesit privat të arsimit dhe aftësimit, institucionet profesionale post- sekondare, universitetet dhe institucionet tjera të arsimit të lartë. Mësimi mund të zhvillohet në kontekste formale, jo- formale dhe të mësuarit në jetën dhe punën e përditshme.

Të gjitha vlerësimet për kualifikime dhe module në KKK duhet të kenë cilësinë e siguruar për t'u bindur se janë korrekte dhe objektive, fleksibile, valide, të besueshme, të mjaftueshme, praktike dhe me kosto efektive si dhe transparente.
Zakonisht do të kombinojë kontrollin e brendshëm që kryhet nga institucioni, i cili bën vlerësimin, si dhe kontrolli i jashtëm nga një institucion i jashtëm. AKK do të luajë një rol të rëndësishëm në fuqizimin e elementeve të jashtëm, në procesin e sigurimit të cilësisë.

Përveç sigurimit të cilësisë së vlerësimit, KKK do të mbështetesë institucionet në fuqizimin e cilësisë së kualifikimeve, duke hartuar raporte të vetëvlerësimit, planit zhvillimor dhe përmes implementimit të strategjive edhe përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Secili kualifikim në KKK do të shpie në një certifikatë apo diplomë. Të gjitha certifikatat dhe diplomat do të përmbajnë të dhëna të caktuara të përbashkëta dhe do të shoqërohen nga transkripte, të cilat japin detajet e përmbajtjes së një kualifikimi i cili është arritur nga mbajtësi i kualifikimit.

Struktura themelore e Kornizës përbëhet prej tetë niveleve, në të cilat kualifikimet, modulet dhe çdo komponentë tjetër e kualifikimeve mund të vendosen. Secili nivel i KKK është i përcaktuar me nga një formulim të rezultateve tipike të mësimit. Këto rezultate janë të tri llojeve: njohuri, shkathtësi dhe kompetenca më të gjëra.

Punëtori e realizuar nga AKK për sistemin e kredive në AAP.



KUALIFIKIMET NË KKK

Edhe në sektorin e kualifikimeve janë realizuar një mori aktivitetesh në fusha të ndryshme si: sistemi i kredive, njohja e mësimit paraprak, etj.
Marr parasysh që një nga objektivat e KKK është të mundësojë akumulimin dhe transferin e rezultateve të mësimit ndërmjet konteksteve të ndryshme të mësimit apo sistemeve, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin formal, joformal dhe informal, AKK ka zhvilluar sistemin e kredive për AAP në Kosovë. Janë mbajtur një mori takimesh, të cilat kanë filluar në vitin e kaluar, por kanë vazhduar në vitin 2011, rreth identifikimit të nevojave për sistemin e kredive në Arsimin dhe Aftësimin Profesional. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve së bashku me ekspertët e projektit BE KOSVET V ka punuar rreth marrëveshjes për sistemin e kredisë në AAP, rezultateve të të nxënit, kategorizimit të kualifikimeve, matjen e vëllimi të të nxënit, identifikimin e roleve potenciale dhe përgjegjësive në klasifikimin e kredive të kualifikimeve të AAP brenda KKK-së, po ashtu dhe identifikimin e fushave dhe politikave, të cilat mbështesin implementimin e transferit të kredive dhe akumulimin nga ofruesit e AAP.

AKK ka zhvilluar sistemin e kredive për AAP në Kosovë.





Një nga punëtoritë e zhvilluara për ofruesit e APP-së.

AKK me mbështetjen e Projektit KOSVET V ka zhvilluar dokumentin e politikave dhe udhëzimet për njohjen e mësimit paraprak.

Gjithashtu, në kuadër të këtyre takimeve u zhvilluan dhe diskutuan dokumente të ndryshme rreth sistemit të kredive siç janë: "Rregulla e kombinimit të kredive për kualifikime", "Dizajni i moduleve dhe shpërndarja e kredive për module dhe kualifikime".

Në këto takime morën pjesë ofrues dhe akterë relevant si: zyrtarë të ndryshëm të Divizionit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional nga MAShT, zyrtar nga Divizioni i Arsimit Profesional, sigurimit të cilësisë nga MPMS, drejtor dhe trajner nga qendrat e aftësimit profesional QAP (MPMS), drejtor, mësimdhënës dhe trajner nga shkollat profesionale (MAShT), ofrues tjerë privat të AAP-së, organizata ndërkombëtare si GTZ, Swisscontact, etj.

Pasi që një nga synimet e KKK të Kosovës është edhe zyrtarizmi i mësimit që arrihet përmes arsimit joformal dhe informal, AKK me mbështetjen e Projektit KOSVET V ka zhvilluar dokumentin e politikave dhe udhëzimet për njohjen e mësimit paraprak. Fillimisht është bërë identifikimi të nevojave dhe zbatimit të njohjes të mësimit paraprak, përmes konsultimeve me përfituesit dhe akterët kryesor, duke i parë për së afërmi praktikat e përdorura, si dhe përfitimet e sfidat që ballafaqohen aktualisht këta ofrues. Mësimet e nxjerra përmes këtij identifikimi kanë ndihmuar në zhvillimin e Udhëzuesit për Njohjen e Mësimit Paraprak të nxjerrë nga AKK. Në kuadër të këtij hulumtimi u mbajtën rreth katërmbëdhjetë (14) takime me ofrues të ndryshëm siç janë zyrtarë të Divizionit të Arsimit për të rritur nga MAShT, zyrtarë nga Divizioni i Arsimit Profesional, Sigurimit të Cilësisë dhe Divizionit të Punësimit në MPMS, drejtor dhe trajner nga qendrat e aftësimit profesional QAP (MPMS), këshilltar nga qendra për punësim (MPMS), koordinator të projektit BE KOSVET VI, udhëheqësi i OJQ-së për trajnime profesionale (APPK), drejtor, mësimdhënës dhe trajner (SHME "Ymer Prizreni"), etj.



Takim në mes stafit të AKK-së me ekspertët e projektit BE KOSVET V.

Janë realizuar dhjetëra takime ndërmjet AKK dhe Projektit KOSVET V, ku është diskutuar dhe punuar në përmbajtjen e udhëzuesit për NJMP bazuar në udhëzuesin evropian për validimin e mësimit joformal dhe informal dhe kontekstin tonë socio-ekonomik.



Po ashtu, është realizuar edhe një punëtori në të cilën është prezantuar gjendja momentale e praktikave të NJMP në Kosovë, është prezantuar dhe diskutuar drafti dokumenti i politikave për NJMP dhe roli i AKK-së dhe KKK-së në NJMP.

Më përkrahjen e DVV internacional është organizuar punëtoria mbi sfidat e arsimit të të rriturve në Kosovë. Objektivat e kësaj punëtorie ishin të paraqitet gjendja ekzistuese dhe sfidat e arsimit të të rriturve në Kosovë, diversiteti i akterëve relevant të përfshirë në arsimin e të rriturve në Kosovë, si dhe roli i Kornizës dhe AKK-së në përmirësimin e arsimit të të rriturve në Kosovë.

Me qëllim të elaborimit të mëtejshëm të niveleve të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve që vlejnë për Arsimin e Lartë, përkatësisht nivelet e KKK 6, 7 dhe 8 (të cilat korrespondojnë me nivelet të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve – (EQF).) AKK me përkrahjen e Këshillit të Evropës përmes WUS Kosovës ka themeluar një grup punues. Qëllimi i "Grupit Punues" ishte përmirësimi i dokumentit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në përputhje me trendet evropiane të AL dhe në përputhje me kërkesat kombëtare, duke zhvilluar një aneks të plotë, të qëndrueshëm dhe cilësor të KKK në nivelet të cilat i takojnë AL në Kosovë. Puna e këtij grupi është prezantuar ne një diskutim publik me të gjithë akterët relevant të Arsimi të lartë në Kosovë dhe janë marr parasysh rekomandimet në finalizimin e dokumentit të"Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve" për arsimin e lartë. Ky aneks dokument është inkorporuar në dokumentin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.



Pamje nga profili i salduesit (AKK ka realizuar procesin e verifikimit për standardet profesionale për metalpunues)

STANDARDET PROFESIONALE

Sa i takon sektorit të standardeve profesionale AKK ka realizuar disa aktiviteteve me qëllim të ngritjes dhe krijimit të mekanizmave për zhvillimin e kësaj fushe.

Fillimisht është realizuar një trajnim në të cilin është përfshirë i gjithë stafi i AKK, ndërsa eksperti për standarde i AKK ka qenë i përfshirë në shtatë (7) trajnime për ofruesit e AAP organizuar nga GIZ dhe Swisscontact me mbështetjen e Projektit BE KOSVET V gjatë muajve janar, shkurt dhe mars 2011. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte trajnimi dhe zhvillimi i standardeve profesionale nga ekipet e secilit profil (11 profile), ku pjesëmarrës kanë qenë ekspertët për standarde nga BE KOSVET V, përfaqësues të GIZ, Swisscontact, KEK, mësimdhënësit e profileve të caktuara nga Shkolla e Mesme Profesionale "F. Guri dhe Vëllezërit Çaka", Shkolla e Mesme Teknike "Shaban Spahija", Shkolla e Mesme Bujqësore "Abdyl Frashëri". Po ashtu, janë mbajtur edhe disa takime ndërmjet Projektit BE KOSVET V dhe AKK, ku kryesisht këto takime kanë pasur qëllimin hartimin dhe rishikimin e dokumenteve për zhvillimin e standardeve profesionale, moduleve e kualifikimeve, si dhe dokumentet për verifikim të standardeve profesionale.

Gjithashtu, AKK me mbështetje të BE KOSVET V dhe GIZ ka realizuar procesin e verifikimit të standardeve profesionale për dymbëdhjetë (12) profile, ku janë përfshirë dhjetë (10) institucione, si Shkolla e Mesme Bujqësore "Abdyl Frashëri, Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj, Qendra Regjionale e Aftësimit Profesional -Prishtinë, Shkolla e Mesme Teknike "Shaban Spahija", Pejë, Kompani "White House" Pejë, etj. Kryesisht këto takime kanë pasur qëllimin e testimit të procesit të verifikimit të standardeve profesionale dhe pyetësorit për verifikim të tyre.

AKK ka qenë i përfshirë në shtatë (7) trajnime për ofruesit e AAP organizuar nga GIZ dhe Swisscontact me mbështetjen e Projektit BE KOSVET V gjatë muajve janar, shkurt dhe mars 2011.

Gjithashtu, AKK me mbështetje të BE KOSVET V dhe GIZ ka realizuar procesin e verifikimit të standardeve profesionale për dymbëdhjetë (12) profile, ku janë përfshirë dhjetë (10) institucione



Një nga punëtoritë e realizuara për sigurimin e cilësisë nga AKK.

Në Shkurt të 2011 është nxjerrë Urdhëresa Administrative nga MAShT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioeve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. AKK në fillim të korrikut të 2011 ka realizuar procesin e testimit të kritereve dhe procedurave për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve, si dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë arsim dha aftësim profesional.



RREGULLIMI I KORNIZËS KOMBËTARE TË KUALIFIKIMEVE

KKK është e rregulluar përmes mekanizmave që synojnë të sigurojnë përputhje me aranzhimet dhe kërkesat e përcaktuara për sistemin e kualifikimeve dhe për të siguruar se sistemi ofron kualifikime me cilësi të pranueshme. Mekanizmat për arritjen e këtyre objektivave janë të përqendruar në:

- Validimin dhe aprovimin e kualifikimeve të propozuara për përfshirje në KKK;
- Akreditimin e institucioneve përgjegjëse për vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve të miratuara të KKK-së;
- Sigurimin e cilësisë së institucioneve të akredituara dhe ofrimin e kualifikimeve të validuara.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka punuar shumë në ngritjen e kapaciteteve të veta, zhvillimin e bashkëpunimit me të gjitha palët me interes në fushën e AAP dhe partneritetit me organizatat si motra jashtë vendit dhe në përgatitjen e materialeve dhe dokumenteve të domosdoshme në pajtueshmëri me Ligjin mbi Kualifikimet Kombëtare. Si rrjedhojë e punës në Shkurt të 2011 është nxjerrë Urdhëresa Administrative nga MAShT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. AKK në fillim të korrikut të 2011 ka realizuar procesin e testimit të kritereve dhe procedurave për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve, si dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë arsim dha aftësim profesional. Në këtë testim së bashku me MAShT janë përzgjedhur ofruesit, të cilët e kanë përfunduar raportin e vetëvlerësimit brenda afati të caktuar dhe ky raport ka qenë në përputhje me udhëzimet e dhëna nga AKK. AKK po ashtu ka realizuar pesëmbëdhjetë (15) vizita tek ofruesit e AAP, ku qëllimi i këtyre vizitave ishte verifikimi i dëshmive të ofruara nga ofruesit e AAP me rastin e aplikimit për procesin e testimit të kritereve dhe procedurave të validimit të kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve.

AKK gjatë 2011 me përkrahjen e Projektit BE KOSVET V, ka realizuar tridhjetetetë (38) takime brenda periudhës kohore prej muajit shkurt 2011 deri në muajin tetor 2011. Këto takime kanë pasur qëllim hartimin dhe rishikimin e dokumenteve për sigurim të cilësisë në AAP, përfshirë edhe takimet e paneleve të ekspertëve për shqyrtimin e aplikacioneve të ofrueseve të AAP të përzgjedhur për testim si dhe hartimin e raporteve finale. Gjithashtu, AKK me mbështetjen e Projektit BE KOSVET V ka realizuar gjashtë (6) trajnime për shtatëdhjetetetë (78) institucione që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional në Kosovë gjatë muajve janar dhe mars 2011. Në këto trajnime janë trajnuar drejtorët dhe koordinatorët e sigurimit të cilësisë nga institucionet ofruese të AAP. Qëllimi i këtyre trajnimeve nga AKK dhe BE KOSVET V ishte përgatitja dhe hartimi i raportit të vetëvlerësimit në institucionet e AAP, rëndësia e sigurimit të cilësisë, si dhe përgatitja për procesin e pilotimit për validim të kualifikimeve dhe akreditim të institucioneve nga AKK.

Në bashkëpunim me projektin BE KOSVET V, AKK ka realizuar për ofruesit e AAP katër (4) punëtori gjatë periudhës mars – korrik, objektivat e të cilave ishin sqarimi dhe diskutimi i procesit të hartimit të raportit të vetë-vlerësimit duke u bazuar në parimet dhe kriteret e Kornizës së sigurimit të cilësisë. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga tetëdhjete (80) institucione që ofrojnë Arsim dhe Aftësim Profesional (57 shkolla të AAP të menaxhuara nga MAShT; 9 Qendra të Arsimit dhe Aftësimit Profesional të menaxhuar nga MPMS; OJQ "Diakonia"; Qendra e trajnimit të KEK; Qendra e Trajnimit të PTK; Qendra Trajnuese për Siguri Publike të menaxhuar nga MPB; 5 shkolla speciale të menaxhuara nga MAShT; 2 Qendra të Kompetencave Skenderaj dhe Malishevë; Qendra Sociale Edukative "Don Bosko", MAShT - MPMS).

Ekspertët për sigurim të cilësisë së AKK kanë qenë pjesëmarrës në dy (2) punëtori të rëndësishme, saktësisht punëtoria treditore mbi "Zhvillimin e kapaciteteve në sektorin e Arsimit Fillor në Kosovë "– CDBE mbajtur në Durrës dhe punëtoria treditore për "Kornizën e Kurrikulës së Kosovës" mbajtur në Strugë të Maqedonisë gjatë muajit qershor dhe korrik. Qëllimi i pjesëmarrjes në këto punëtori ishte rreth sfidave gjatë sigurimit të cilësisë në AAP.

Gjithashtu, një pjesë e stafit të AKK ka realizuar edhe një vizitë studimore në Britani të Madhe, me qëllim të shkëmbimit të përvojave për sigurim të cilësisë në Shkollat Teknike Profesionale me aftësi dhe edukim, hapat e inspektimit si dhe sfidat që mund të dalin gjatë ndërtimit të sigurimit të cilësisë në AAP. Vizita është mundësuar nga Këshilli Britanik në Kosovë.



Ekspertët e projektit BE KOSVET V në

AKK me mbështetjen e Projektit BE KOSVET V ka realizuar gjashtë (6) trajnime për shtatëdhjetetetë (78) institucione që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional në Kosovë gjatë muajve janar dhe mars 2011. Në këto trajnime janë trajnuar drejtorët dhe koordinatorët e sigurimit të cilësisë nga institucionet ofruese të AAP. Qëllimi i këtyre trajnimeve nga AKK dhe BE KOSVET V ishte përgatitja dhe hartimi i raportit të vetëvlerësimit në institucionet e AAP

AKK ka realizuar për ofruesit e AAP katër (4) punëtori gjatë periudhës mars – korrik, objektivat e të cilave ishin sqarimi dhe diskutimi i procesit të hartimit të raportit të vetë-vlerësimit duke u bazuar në parimet dhe kriteret e Kornizës së sigurimit të cilësisë. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga tetëdhjete (80) institucione që ofrojnë Arsim dhe Aftësim Profesional

punëtorinë për përpilimin e Raportit të Vet-vlerësimit me ofruesit e AAP-së.



TESTIMI I KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR APROVIMIN E KUALIFIKIMEVE NË KKK DHE AKREDITIMIN E OFRUESEVE TË AAP

Bazuar në Ligjin mbi Kualifikimet Kombëtare dhe me përkrahjen e projektit BE KOSVET V, AKK ka realizuar testimin e kritereve dhe procedurave të validimit dhe akreditimit në njëmbëdhjete (11) Institucione të AAP (Shkolla, Qendra të Aftësimit të MPMS, Qendra të Aftësimit të KEK dhe Institucione tjera) për pesëmbëdhjete (15) Kualifikime Prioritare si në vijim:

Shkolla e Mesme Profesionale "Vëllezërit Çaka dhe Feriz Guri" –Kaçanik me profilet:
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit
- Instalues i ngrohjes dhe Instalues elektrik.

Shkolla e Mesme Teknike "Skender Luarasi"- Therandë:
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit
- Instalues i ngrohjes dhe Instalues elektrik"

Shkolla e Mesme Teknike "Shaban Spahija"– Pejë me profilin:
- Automekanik

Shkolla e Mesme Teknike "Agim Çavderbasha" - Prizren me profilin:
- Metalpunues

Shkolla e Mesme Eletroteknike "Gjin Gazulli"- Prishtinë me profilin:
- Elektronik industrialeShkolla e Mesme e Ekonomike ''Hasan Prishtina" Mitrovicë me profilin:
- Asistent për Kontabilitet

Qendra Sociale Edukative "Don Bosko" – Prishtinë me profilet:
- Teknik i Informatikës
- Saldues

Qendra e Trajnimit- Korporata Energjetike e Kosovës-Kastriot me profilet:
- Instalues elektrik
- Saldues

Qendra Regjionale e Aftësimit Profesional – Prishtinë me profilin:
- Administrim Biznesi

Qendra Regjionale e Aftësimit Profesional – Prizren me profilin:
- Administrim Biznesi

Qendra e Kosovës për Siguri Publike për Edukim dhe Zhvillim – Vushtrri me profilin:
- Zyrtar policor

Trembëdhjetë panele janë organizuar për realizimin e këtij procesi. Çdo panel përbehej nga një zyrtar i AKK, një ekspert i projektit BE KOSVET V, si dhe një ekspert profesional i fushës përkatëse.
Të gjitha aktivitetet janë zhvilluar në periudhën prej 05.07.2011 deri më 30.07.2011, duke përfshirë të gjitha takimet, mbledhjet, vizitat, hartimin e raporteve etj.

Në fillim të procesit është mbajtur një takim me të gjithë ekspertët e paneleve. Ky takim kishte karakter informues në lidhje me fazën e pilotimit të Institucioneve. Procedurat dhe vijueshmëria e punës lidhur me gjitha grupet e panelit ishte si në vijim:

- Takimi për shqyrtimin e aplikacioneve;
- Vizita në terren;
- Përpilimi i raportit final të vlerësimit për validim të kualifikimit dhe akreditim të ofruesve;
- Takim për shqyrtimin e aplikacioneve.

Pas takimit të parë informues rreth procedurave të validimit dhe akreditimit, në kuadër të kësaj faze pilotuese u mbajtën edhe takimet e paneleve për shqyrtimin e materialeve dhe dokumenteve të institucioneve aplikuese.

Panelet së bashku me ekspertët përkatës të profilit, verifikuan dhe kontrolluan aplikacionet për validim dhe akreditim, ku gjatë kësaj faze janë identifikuar nevojat dhe çështjet, të cilat duhej ngritur gjatë takimit që do të mbahet me aplikuesin.
Gjatë këtij takimi u verifikuan edhe dokumentacionet e dëshmuara nga aplikuesit si: Raportet e vetëvlerësimit, literatura, stafi e CV-të dhe dëshmitë tjera.
Në këtë fazë u përgatitën edhe pyetjet dhe çështjet që do t'i parashtrohen ofruesit, të bazuara në aplikacionet dhe dëshmitë tjera.



Vizita në Qendrën e Trajnimit - Korporata Energjetike e Kosovës.



VIZITA NË TERREN

Gjatë vizitave ne terren panelet u pritën nga menaxheret e institucioneve, zyrtarët për sigurim të cilësisë dhe mësimdhënësit/trajnerët e profileve përkatëse.
Fillimisht gjatë vizitës u zbatua verifikimi i gjendjes, dëshmive dhe materialeve sipas Aplikacionit për Validim të Kualifikimeve. Sipas procedurave për validimin e kualifikimit u verifikuan këto pika:

- Modulet
- Struktura e kualifikimit
- Numri i kredive
- Qëllimi dhe përmbajta e kualifikimit/modulit
- Niveli i kualifikimit/modulit në KKK
- Pjesa teorike dhe praktike
- Standardet profesionale
- Njohja e mësimit paraprak
- Mënyra dhe kriteret e vlerësimit
- Literatura

Po ashtu, gjatë vizitës edhe sipas aplikacionit për Akreditimin e ofruesve u bë verifikim i gjendjes, dëshmive, infrastrukturës dhe materialeve, duke përfshirë këto pika:

- Pajisjet dhe mjetet për praktikë
- Kabinetet dhe punëtoritë
- Gjendja financiare
- Stafi dhe menaxhmenti
- Kriteret dhe politikat për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta
- Qasje të barabartë për kandidatë
- Siguria dhe shëndeti
- Certifikimi
- Data baza

Po ashtu, u vlerësua përshtatshmëria e objektit me kualifikimin e ofruar, infrastruktura për kandidatë me nevoja të veçanta, siguria dhe çështje tjera me interes.



Konferencë për shtyp, procesi i testimit të kritereve dhe procedurave për validim dhe akreditim.

PËRPILIMI I RAPORTIT FINAL TË VLERËSIMIT PËR VALIDIM DHE AKREDITIM

Në kuadër të kësaj detyre të fazës pilotuese, panelet përkatëse përpiluan draft raportet për kualifikimet dhe ofruesit përkatës. Raportet u krijuan duke u bazuar ne dokumentet, materiale dhe dëshmitë e ofruara përfshirë edhe vizitat në institucione. Raportet janë pasqyrim i gjendjes tek ofruesit dhe vlerësimi i panelit u bë konform kritereve të Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga Ligji për Kualifikime Kombëtare.



Testimi i kritereve dhe i procedurave për validim dhe akreditim është përcjellë edhe me disa punëtori për të bërë revidimin e këtyre procedurave sipas të gjeturave dhe vështirësive që kanë përcjellë procesin, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet të cilat kanë pjesë procesit të Validimit dhe Akreditimit.

Të gjitha draft raportet janë kthyer në institucione për ta bërë vlerësimin/ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar sipas procedurave të UA.
Pas kësaj procedure raportet finale i janë dërguar Këshillit Drejtues të AKK me rekomandime për aprovim ose mosaprovim.Puna e paneleve është mbikëqyrur dhe udhëhequr nga ana e znj. Teuta Danuza - u.d. Drejtores së AKK dhe David Handley – udhëheqës i ekipit te BE KOSVET V.

Ky testim i procedurave është përcjellë edhe me disa punëtori për të bërë revidimin e procedurave për validimin e kualifikimeve dhe akreditimin e ofruesve sipas të gjeturave dhe vështirësive që e kanë përcjellë procesin, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet që ju kanë nënshtruar procesit të Validimit dhe Akreditimit.



Z. Ramë Buja, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duke prezantuar rezultatet e procesit të testimit të kritereve dhe proceduarve për validim të kualifikimeve dhe akreditim të institucioneve profesionale



Z. Christof Stoch, udhëheqës i Operacioneve të Zyrës Ndërlidhëse të KE, duke prezantuar rezultatet e procesit të testimit të kritereve dhe proceduarve për validimiin e kualifikimeve dhe akreditimin e ofruesve të AAP-së.



Pamje nga dosjet e arkivuara nga procesi i testimit të kritereve dhe procedurave për validim dhe akreditim.

AKK ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji të vazhdueshme të komunikimit për të mbajtur të gjitha palët e interesit, duke përfshirë publikun e gjerë të informuar mirë.

PROMOVIMI I KKK DHE AKK

AKK ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji të vazhdueshme të komunikimit për të mbajtur të gjitha palët e interesit, duke përfshirë publikun e gjerë të informuar mirë. Kjo është bërë nëpërmjet aktiviteteve dhe mjeteve të ndryshme si në vijim:

- Krijimi i takimeve me palët e interesit (ofruesve publik, privat dhe në përgjithësi të ofruesve të AAP) në baza të rregullta;
- Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik / privat;
- Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara;
- Botimi i materialeve promovuese për audiencën e përgjithshme dhe audiencë të synuar;
- Zhvillimi dhe rishikimi i web-faqes.



Punëtori rreth Udhëzimit Administrativ e mundësuar nga British Council.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) me përkrahjen e Këshillit Britanik gjatë muajit mars ka zhvilluar tri (3) punëtori me karakter informuese mbi përmbajtën e Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga Ligji mbi Kualifikimet Kombëtare në shkurt të këtij viti



ORGANIZIMI I KONFERENCAVE, PUNËTORIVE INFORMUESE PËR KKK / SEMINARE PËR GRUPE TË NDRYSHME TË CAKTUARA PËR SEKTORIN PUBLIK / PRIVAT



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) me përkrahjen e Këshillit Britanik gjatë muajit mars ka zhvilluar tri (3) punëtori me karakter informuese mbi përmbajtën e Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga Ligji mbi Kualifikimet Kombëtare në shkurt të këtij viti. Synimi i punëtorive ishte vetëdijesimi i akterëve relevant mbi kriteret dhe procedurat e validimit të kualifikimeve profesionale dhe akreditimit të të gjithë ofruesve të kualifikimeve profesionale. Pjesëmarrës në këto punëtori ishin palët me interes në AAP ne nivel qendror dhe rajonal, ofrues të arsimit dhe aftësimeve profesionale (shkollat profesionale, qendrat e aftësimit profesionale etj.) dhe punëdhënës.



Konferencë gjysmë ditore e mbajtur nga AKK në Mitrovicë.



Konferencë gjysmë ditore e mbajtur nga AKK në Prizren.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) me përkrahjen e projektit BE KOSVET V ka zhvilluar fushatën informuese mbi implementimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe për përhapjen e rezultateve të projektit BE KOSVET V. Kjo fushatë ka filluar me 11 tetor 2011 me konferencën për shtyp të ministrit të Arsimit, kryetarit të Bordit të AKK, kryesuesit të operacioneve të ZNKE, ushtruesit të Drejtorit të AKK dhe udhëheqësit të projektit BE KOSVET V, ku kjo ngjarje është mbuluar nga disa gazeta kombëtare dhe TV.

Si pjesë e fushatës informuese për opinionin publik, AKK me mbështetjen e BE KOSVET V ka realizuar pesë (5) konferenca rajonale në muajin nëntor, me qëllimin e realizimit të fushatës informuese për implementimin e KKK dhe për përhapjen e rezultateve të projektit.



Konferenca përmbyllëse e projektit BE KOSVET V, Prishtinë.



Theksi kryesor ishte në promovimin e përfitimeve nga KKK dhe akreditimi i institucioneve për bizneset, ofruesit dhe individët. Po ashtu, kjo ngjarje është përkrahur nga projektit BE KOSVET V.

Konferenca finale e projektit BE KOSVET V është mbajtur në Prishtinë në fillim të dhjetorit. Konferenca është planifikuar si një ngjarje e përbashkët me AKK, duke ofruar një mundësi për akterët e sistemit për aprovimin e kualifikimeve në KKK dhe akreditimin e institucioneve, si dhe shpërndarjen përfundimtare të të gjitha rezultateve të projektit. Ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, zëvendës Ministri i Zhvillimit Ekonomik, zëvendës Ministri i Integrimeve Evropiane si dhe kryesuesi i operacioneve të ZNKE ju drejtuan pjesëmarrësve të konferencës.



Konferencë gjysmë ditore e mbajtur nga AKK në Ferizaj.

Konferenca përmbyllëse e projektit BE KOSVET V është planifikuar si një ngjarje e përbashkët me AKK. Në konferencë është prezantuar KKK e aprovuar nga KD i AKK-së dhe rezultatet e projektit BE KOSVET V.



Konferenca përmbyllëse e projektit BE KOSVET V, Prishtinë.





Pamje nga prezantuesit në konferencën BE KOSVET V, Prishtinë.


VALIFIKACIJE
Implemented by:
PEM
Z. Ragip Gjoshi
MASHT
Mr. David Handley
EU Kosvet V



Prezantuesit në konferencën përmbyllëse të projektit BE KOSVET V.


PEM
mented by:



Prezantuesit në konferencën përmbyllëse të projektit BE KOSVET V.





Ekipi drejtues i projektit BE KOSVET V.


IKIMEVE
WORK
JE

PJESËMARRJA NË MEDIA ELEKTRONIKE DHE TË SHKRUARA

Për të gjeneruar vetëdijesimin e publikut në përgjithësi, një fushatë me reklama televizive është zhvilluar si rezultat i projektit BE KOSVET V. Kjo ka përfshirë reklamat në kanale televizive kombëtare (shqip dhe serbisht), reklamat në radio dhe reklama në gazeta (gjysmë faqe) gjatë periudhës së fushatës (dy javët e fundit të dhjetorit). Mesazhi promovues kishte synim që të bëjë publik rolin e AKKsë dhe KKK, duke bërë transparente se nga ky institucion dhe KKK përfitojnë nxënësit, duke krijuar mundësi të reja për t'u bërë të kualifikuar ose të ketë kualifikime të njohura, përfitojnë bizneset duke siguruar se kualifikimet janë dizajnuar për të përmbushur kërkesat e tregut të punës dhe përfitojnë ofruesit duke mbështetur zhvillimin e një tregu për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

U.d drejtorja Danuza e AKK ka marrë pjesë në një numër të programeve televizive dhe të radios, në të cilat është diskutuar roli i AKK, funksioni dhe objektivat e KKK, mekanizmat e zhvilluara nga KKK për zbatimin e KKK, si dhe përfitimet e individit nga zbatimi i KKK.

Gjatë këtij viti aktivitetet e AKK u përcollën dhe u publikuan në mediat e shkruara në më shumë se 22 raste. Artikuj të ndryshëm mbi aktivitetet e AKK u publikuan ne këto mediume: Koha Ditore, Zëri, InfoPress, Kosova Sot, Exspress, Lajm, Tribuna Shqiptare dhe Epoka e re.

U.d drejtorja Danuza e AKK ka marrë pjesë në një numër të programeve televizive dhetë radios, në të cilat është diskutuar roli i AKK, funksioni dhe objektivat e KKK, mekanizmat e zhvilluara nga KKK për zbatimin e KKK, si dhe përfitimet e individit nga zbatimi i KKK.

Gjatë këtij viti aktivitetet e AKK u përcollën dhe u publikuan në mediat e shkruara në më shumë se 22 raste.



Pjesë e mesazhit televiziv për promovimin e KKK-së dhe AKK-së.




Pamje nga artikujt e publikuar në media të shkruara për KKK-në dhe AKK-në.


NË PËRMBUSHUR


Botimet e publikuara nga AKK.

BOTIMI I MATERIALEVE PROMOVUESE PËR AUDIENCËN E PËRGJITHSHME DHE AUDIENCËN E SYNUAR






AKK me ndihmën e DVV internacional ka publikuar një Fletushke/Fletëpalosje informative në gjuhën shqipe. Fletëpalosja përmban informata mbi rolin e AKK në raport me KKK, si dhe përfitimet e individit, partnerëve socialë dhe ofruesve të AAP nga zbatimi i KKK. Fletushka është shpërndarë në një numër të madh të ngjarjeve dhe takimeve të ndryshme me palët e interesit.



Një nga pjesëmarrëset në punëtoritë e organizuara, lexon fletushkën e AKK-së.



KORNIZA
KOMBËTARE
E KUALIFIKIMEVE
Prishtinë, Dhjetor 2011
Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian



Me përfundimin e projektit BE KOSVET V, është identifikuar nevoja për publikimin dhe shpërndarjen e dokumenteve të prodhuara nga projekti. Këto dokumente janë publikuar në një format të përshtatshëm e tërheqës dhe janë grupuar si në vijim:

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE

Ky është një dokument i rëndësishëm, i cili përcakton në detaje kontekstin e politikave dhe kërkesave kryesore të sistemit profesional të kualifikimeve.

ZHVILLIMI I STANDARDEVE PROFESIONALE DHE KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Kjo është një pako me udhëzime praktike dhe materiale përkatëse burimore, që iu dedikohet atyre që merren me hartimin dhe zhvillimin e kualifikimeve profesionale për përfshirje në KKK. Kjo përbëhet nga një dosje ose kuti ku përfshihen shtesat mbi zhvillimin dhe verifikimin e standardeve profesionale, përcaktimin e rezultateve të mësimit dhe moduleve, zhvillimin e kualifikimeve modulare të AAPsë, vlerësimin e kualifikimeve modulare të AAP-së, verifikimin e brendshëm të vlerësimeve, regjistrimin dhe certifikimin e kandidatëve, qasjen për persona me aftësi të kufizuar dhe/ose me nevoja të veçanta;

SIGURIMI I CILËSISË NË INSTITUCIONET E AAP-SË: NJË UDHËZUES PRAKTIK PËR IMPLEMENTIMIN

Dokumenti përmban udhëzime praktike dhe materiale burimore përkatëse të synuara për ofruesit e AAP-së për të mbështetur implementimin e procedurave të sigurimit të cilësisë në nivel institucional, duke përfshirë instrumentin e vetëvlerësimit dhe listat kontrolluese të planifikimit zhvillimor dhe instrumentet për përgatitje për inspektime.

Gjithashtu është një numër i publikimeve të tjera si më poshtë:

- Udhëzuesi për zhvillimin e mëtejshëm të një sistemi të cilësisë për AAP;
- Udhëzuesi për plotësimin e aplikacioneve për verifikim dhe akreditim;
- Raporti i AKK-së2011 dhe Plani i Punës për 2012;
- Posterat e vendosur në ndërtesat publike dhe në objektet e institucioneve të arsimit dhe të aftësimit dhe punëdhënësve.

Ueb-faqja përmban informata, dokumente dhe publikime, të cilat aprovohen nga KD i AKK. Po ashtu, përmban informata për projektin BE KOSVET V, si dhe partnerë/donatorët tjerë të AKK, linçe dhe informata të mjaftueshme për të gjithë akterët relevant të KKK.



ZHVILLIMI DHE RISHIKIMI I UEB-FAQES

Me ndihmën e projektit BE KOSVET V është zhvilluar dhe lancuar ueb-faqja e AKK. Ueb-faqja përmban informata, dokumente dhe publikime, të cilat aprovohen nga KD i AKK. Po ashtu, përmban informata për projektin BE KOSVET V, si dhe partnerë/donatorët tjerë të AKK, linçe dhe informata të mjaftueshme për të gjithë akterët relevant të KKK.

Është menduar gjithashtu që të gjitha dokumentet e projektit të synuar për shpërndarjen e jashtme të publikohen gjithashtu në ueb-faqen e AKK-së në format elektronik. Ueb-faqja e AKK-së, e zhvilluar në një fazë të hershme të projekti, tashmë ofron informata themelore për KKK, AKK dhe projektin. Megjithatë uebfaqja duhet të përmirësohet në mënyrë që të sistemojë një sasi të konsiderueshme të informatave dhe të ofrojë forma të përmirësuara kërkimi si dhe ndërlidhje shtesë me ueb-faqet përkatëse. Ueb-faqja duhet gjithashtu të përfshijë video dhe audio incizimet të përdorura në fushatën e mediave për të siguruar qëndrueshmëri të vazhdueshme të mesazheve të promovuara.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

AKK synon gjithnjë në krijimin dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve me rrjetet e BEsë dhe organizatave si motra në rajon dhe BE, duke marrë parasysh që një nga objektivat e KKK është lidhja e sistemit kombëtar të kualifikimeve me KEK, duke mundësuar kështu njohje dhe krahasueshmëri ndërkombëtare të kualifikimeve të Kosovës me ato të vendeve evropiane.

KKK e Kosovës gjatë vitit 2011 ka qenë pjesë e studimi mbi KKK në mesin e 10 vendeve të botës. Studimi përfshinë kornizat e 10 vendeve, të cilat kanë kontekste dhe sfida shumë të ndryshme të zhvillimit të kornizave dhe janë në faza të ndryshme në planifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e kornizave të tyre. Studimi analizoi aktivitetet vijuese kyçe dhe funksione:

- koordinimin e kornizës
- përpunimin e standardeve dhe kualifikimeve
- vlerësimin e certifikimit dhe të sigurimit të cilësisë
- implikime për ofruesit e trajnimeve
- komunikimin e KKK

Studimi ka paraqitur akterët relevant dhe institucionet kyçe në zbatimin e KKK. Gjetjet e këtij studimi u prezantuan në konferencën "Kornizat e Kualifikimeve, nga konceptet tek implementimi" organizuar nga e ETF e mbajtur në Bruksel në Parlamentin e Evropës.

AKK në vitin 2011 është ftuar nga ETF si pjesë e procesit të testimit të projektit "Platforma e Kualifikimeve". "Platforma e Kualifikimeve" është një iniciativë e ETF për të mbështetur grupet e interesit në vende të ndryshme në zbatimin e kornizave të tyre në mënyrë virtuale. Synon të sjellë aktorët së bashku; për të adresuar çështjet konkrete, të cilat mund të zgjidhen me ndihmën e kolegëve; krijimin e grupimeve rajonale dhe tematike, tregon një pasqyrë të zhvillimeve ndërkombëtare etj. AKK ka qenë pjesë e testimi të këtij projekti.

Projekti "Platforma e Kualifikimeve" u opercionalizua në konferencën "Kornizat e Kualifikimeve, nga konceptet tek implementimi" organizuar nga e ETF e mbajtur në Bruksel në Parlamentin e Evropës.

Po ashtu, AKK ka marrë pjesë në një numër të ngjarjeve ndërkombëtare si në vijim:
Vizita studimore "Sigurimi i Cilësisë në Shkollat Teknike dhe Profesionale" Londër, Angli, 14 – 17 Mars

Kjo vizitë është organizuar dhe mbështetur nga Këshilli Britanik, në të cilën është prezantuar strategjia, mjetet, sistemet, praktikat e mirë, të arriturat dhe sfidat për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Angli. Objektivat e kësaj vizite ishin diskutimi dhe shkëmbimi i përvojave lidhur me rolin dhe rëndësinë e sigurimin e cilësisë në Britani të Madhe, nëpërmjet vizitave në kolegje dhe të dhënave nga menaxherët e sigurimit të cilësisë dhe të Inspektorëve si dhe shqyrtimi i elementeve te ndryshme të sigurimit të sigurimit të cilësisë në Mbretërinë e Bashkuar si modele të mundshme për vendet pjesëmarrëse.

Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga 12 shtete, prej vendeve të ndryshme, si nga Shqipëria, Algjeria, Bullgaria, Kroacia, Egjipti, Kazakistani, Kosova, Mali i Zi, Maroku, Palestina, Ukraina dhe Uzbekistani. AKK në këtë konferencë u përfaqësua nga Teuta Danuza, Avni Gashi, Kaltrina Mulliqi.

Punëtoria "Implementimi i qëndrueshëm i një Kornize Kombëtare të Kualifikimeve", Torino, Itali, 17-18 Maj



Pamje nga punëtoria e organizuar nga ETF, Torino, Itali.

Punëtoria është udhëhequr nga AKK, ndërsa është organizuar nga ETF (Europian Tranining Found). Qëllimi i kësaj punëtorie ishte të identifikojë sfidat e implementimit të KKK në Kosovë, si dhe nxjerrja e rekomandimeve për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të kualifikimeve. Pjesëmarrës ishin rreth 35 persona, të cilët përfaqësonin Këshillin Drejtues dhe stafin e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshillin për Arsim dhe Aftësim Profesional, Arsimin e Lartë-MAShT dhe Fondacioni Evropian për Trajnime. Po ashtu, gjatë kësaj punëtorie u paraqiten disa praktika nga disa ekspertë ndërkombëtarë të ETF në lidhje me implementimin e KKK, të cilat mund të aplikohen edhe në vendin tonë me qëllim të ngritjes së cilësisë në sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional. Grupet punuese paraqitën veprime konkrete, të cilat do të ndihmojnë në krijimin e sistemit të kualifikimeve kombëtare përmes Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve të Kosovës është një ndër kornizat më të avancuara në rajon sa i përket çështjes se zhvillimit dhe implementimit të saj vlerësuan ekspertët ndërkombëtar në këtë punëtori.

KKK e Kosovës gjatë vitit 2011 ka qenë pjesë e studimi mbi KKK në mesin e 10 vendeve të botës. Studimi përfshinë kornizat e 10 vendeve, të cilat kanë kontekste dhe sfida shumë të ndryshme të zhvillimit të kornizave dhe janë në faza të dryshme në planifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e kornizave të tyre.

AKK në vitin 2011 është ftuar nga ETF si pjesë e procesit të testimit të projektit "Platforma e Kualifikimeve". "Platforma e Kualifikimeve" është një iniciativë e ETF për të mbështetur grupet e interesit në vende të ndryshme në zbatimin e kornizave të tyre në mënyrë virtuale.

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve të Kosovës është një ndër kornizat më të avancuara në rajon sa i përket çështjes se zhvillimit dhe implementimit të saj vlerësuan ekspertët ndërkombëtar në këtë punëtori




Gjatë punëtorisë të organizuar nga ETF, Torino, Itali





Pjesëmarrësit e punëtorisë të organizuar nga ETF , Torino, Itali.





Nga konferenca "Korniza Evropiane e Kualifikimeve" në Budapest, Hungari.

Konferenca "**Korniza Evropiane e Kualifikimeve**"
Budapest, Hungari, 25-26 Maj,

Qëllimi i konferencës mbi **Kornizën Evropiane të Kualifikimeve** e mbajtur në Budapest të Hungarisë dhe e organizuar nga Presidenca Hungareze e Bashkimit Evropian dhe ETF (Europian Tranining Found), ishte që të reflektojë mbi përvojën e zbatimit të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve në nivel Evropian por edhe në nivel vendi, si dhe gjithashtu për të eksploruar mënyra të reja dhe orientimet për shfrytëzimin e potencialit që ka KEK. Pjesëmarrës ishin rreth 200 persona, të cilët përfaqësonin institucionet përgjegjëse rreth implementimit të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve të shteteve të ndryshme të Evropës, si dhe jashtë saj, përfaqësues të Komisionit Evropian, Cedefop (European Centre for the Development of Vocational Training), ETF (Europian Tranining Found), ILO (International Labour Organization) etj.

Në kuadër të kësaj konference u mbajt edhe punëtoria:

Për vendet para-aderimit në Kornizën e Kualifikimeve
Kjo punëtori u fokusua në dy qëllime kryesore:

- Në mbështetje të reformave të arsimit dhe trajnimit në vendet përkatëse, zhvillim më të integruar, përkatësisht mësimin gjatë gjithë jetës;
- Për lidhjen dhe integrimin e vendeve në kuadër të KK me hapësirën evropiane të arsimit, si dhe KEK.

Në kuadër të punëtorisë u prezantuan dy panele: në njërin u paraqiten shtetet që kanë filluar implementimin e KKK dhe në tjetrin shtetet që janë në planifikim të Kornizës Kombëtare.
Në këtë punëtori u.d drejtorja e AKK-së, znj. Danuza, ishte paneliste në grupin e shteteve që implementojnë KKK. Gjatë kësaj punëtorie u shtruan edhe çështjet sfiduese të përbashkëta të këtyre shteteve në implementimin e KKK-së siç janë: kapacitetet institucionale dhe njerëzore, krijimi i një partneriteti efektiv dhe burimet financiare.



Takim në Odën Ekonomike në Tallin, Estoni.



Vizita në "Kutsekoda" u organizua nga projekti "BE KOSVET V" me kërkesën e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve të vendit tonë, me qëllim të informimit dhe shkëmbimit të përvojave nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve të Estonisë, me theks të veçanet për mekanizmat e rregullimit të Kornizës.

Vizita studimore në Autoritetin Kombëtar të Estonisë " Kutsekodda" Tallin, Estoni, 18-24 Shtator

Një delegacion i Bordit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), i udhëhequr nga Ragip Gjoshi, kryetar i bordit, dhe u.d. drejtores së AKK-së, Teuta Danuza, qëndroi për një javë në Estoni. Vizita u organizua nga projekti "BE KOSVET V" me kërkesën e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve të vendit tonë, me qëllim të informimit dhe shkëmbimit të përvojave nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve të Estonisë, me theks të veçanet për mekanizmat e rregullimit të Kornizës. Zyrtarët e AKK-së gjatë kësaj vizite u informuan lidhur me sistemin arsimor, sidomos në arsimin profesional, për strukturën, objektivat dhe mekanizmat e Kornizës , përfshirë standardeve profesionale, kualifikimet si dhe sigurimin e cilësisë në Kornizën e Kualifikimeve në Estoni.

Një pjesë e delegacionit kosovar mori pjesë në konferencën ndërkombëtare "Peer Learning Activity" organizuar nga Autoriteti i Kualifikimeve Estoneze.

Takim për Cilësinë, Sigurimin e Cilësisë, Vlerësimin e Jashtëm, Raportet e Vetë-vlerësimit në shkollat profesionale, Budva, Mali i Zi, 27-30 Shtator

Kjo punëtori katër ditore u organizua nga ETF me qëllim të përmbylljes së ciklit të takimeve që lidhen me cilësinë, sigurimin e cilësisë, vlerësimin e jashtëm, raportet e vetë-vlerësimit në shkollat profesionale, të mësuarit nga përvojat dhe shkëmbimi i praktikave për sigurim të cilësisë në Mal të Zi. Po ashtu, janë diskutuar strategjitë e mëtejme dhe veprimet, të cilat mund të jenë të dobishme për shkollat e aftësimit profesional dhe hartuesit e politikave për AAP në rajon, si një qasje për zhvillimin e cilësisë në sistemet e aftësimit profesional edhe në tërë rajonin. Pjesëmarrësit në këtë vizitë ishin nga shume vende të rajonit si: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Islanda, Kosova, Mali i Zi, Portugalia, Serbia, Turqia, si dhe ekspertet nga ETF-ja. AKK në këtë takim u përfaqësua nga Avni Gashi.

Konferenca "Arsimi Post Sekondar në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Vendet e BE" Torino, Itali, 17-18 Tetor

AKK ka marrë pjesë në konferencën mbi Arsimin Postsekondar në Arsimin dhe Aftësimin Profesional e mbajtur në Torino të Italisë dhe organizuar nga ETF (Europian Tranining Found). Kjo ishte konferenca përmbyllëse e projektit tre-vjeçar "Arsimi dhe Aftësimi Profesional post-sekondar" organizuar nga EFT, pjesë e së cilës ishte edhe AKK. Projekti ka inkurajuar diskutimin dhe shkëmbimin e njohurive lidhur me modelet dhe kushtet për zhvillimin e AAPn post-sekondar. Qëllimi i kësaj konference ishte reflektimi dhe shkëmbimi i informatave dhe përvojave për programet e Nivelit te 5 apo nivelit post sekondar ne KKK dhe promovimi i të mësuarit reciprok në nivele të ndryshme të politik-bërjes dhe implementimit te modeleve të reja gjithëpërfshirëse në arsimin terciar. Pjesëmarrës ishin rreth 50 persona, të cilët përfaqësonin institucionet përgjegjëse rreth implementimit të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe të Evropës, përfaqësues të Komisionit Evropian, ETF (Europian Tranining Found), etj.

Konferenca "Korniza e Kualifikimeve e Kroacisë i Referohet Kornizës Evropiane të Kualifikimeve " Split, Kroaci, 27 Tetor

Po ashtu, AKK ishte pjesëmarrëse në konferencën "Korniza e Kualifikimeve e Kroacisë i Referohet Kornizës Evropiane te Kualifikimeve" mbajtur në Split të Kroacisë dhe organizuar nga Ministria e Shkencës, Arsimit dhe Sportit e Kroacisë dhe ERISEE (organizatë joqeveritare – implementuese e rrjetit rajonale). Qëllimi kryesor i konferencës ishte që të diskutojë me gjithë akterët relevant ndërkombëtarë dhe ekspertët e fushës së referimit të kornizave kombëtare të kualifikimeve për procesin e referimit të Kornizës Kroate të Kualifikimeve ndaj dy meta-kornizave të kualifikimeve, te cilat janë adaptuar ne nivelin evropian. Theksi i veçantë në konferencë i është dhënë çështjes së transparencës dhe sigurimit të cilësisë dhe përvoja në përgatitjen e referimit kroat dhe Raportit të vetë-certifikimit nën udhëheqjen e pesë ekspertëve ndërkombëtarë. Këta ekspertë po ashtu kanë prezantuar në Konferencë. Prezantuesit kanë pasqyruar zbatimin e rekomandimeve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe kanë nxitur diskutime mbi sfidat e implementimit të Kornizave të Kualifikimeve në shtete të ndryshme. Kosova është përmendur si një nga vendet më të avancuara në rajon sa i përket implementimit të KKK. Pjesëmarrës ishin rreth 70 persona, të cilët përfaqësonin institucionet përgjegjëse rreth implementimit të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve të shteteve të ndryshme të Evropës si dhe jashtë saj.

Takimit i parë rajonal për "Zhvillimin e Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve" Split, Kroaci, 28 Tetor

AKK ishte pjesëmarrëse edhe në takimit e parë rajonal për "Zhvillimin e Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve"e mbajtur në Split të Kroacisë dhe e organizuar nga Ministria e Shkencës, Arsimit dhe Sportit e Kroacisë dhe ERISEE (organizatë joqeveritare – implementuese e rrjetit rajonal). Qëllimi kryesor i takimit rajonal për zhvillimin e KKK ishte shkëmbimi i përvojave të përfaqësuesve në nivel shteti për progresin e zhvillimit të Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve. Është diskutuar krahasueshmëria e kualifikimeve të Arsimit të Lartë në kontekstin e Procesit të Bolonjës dhe Arsimit të Lartë Evropian. Po ashtu është prezantuar gjendja dhe praktikat e njohjes së mësimit paraprak në të gjitha shtetet. AKK në këtë takim është përfaqësuar nga kryetari i KD të AKK, Ragip Gjoshi, dhe u.d drejtore, Teuta Danuza.

Kosova është përmendur si një nga vendet më të avancuara në rajon sa i përket implementimit të KKK.

Për më shumë informata, ju lutem na kontaktoni:

Qendra e Studentëve
Rr. Agim Ramadani p.n.
Prishtinë, 10000, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 212 595
Fax: +381 (0) 38 213 433

www.akk-ks.net

Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

Implementuar nga: PEM CONSULT